



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

Procesverbal

Nga mbledhja e 3-të e Bordit Ekzekutiv të FPPK-së e mbajtur me 29.07.2026 me fillim nga ora 17:00 në zyre e takimeve në Hotel Marriot.

Në mbledhje ishin prezent: Nehat Çitaku, Besim Hajdari, Bjondina Hasani, Gani Pireva, Jahja Termkolli, Nita Baymak, Riana Rifati Canhasi dhe Sheremet Hoti.

Mungun me arsye: Ardian Lamaxhema, ShEGA Hashani

Prezent ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm, Fadil Luta, i cili u caktua të mbajë procesverbalin e takimit.

Mbledhjen e udhëhoqi Kryetari, Nehat Çitaku, i cili në fillim i përshëndeti të pranishmit duke u uruar mirëseardhje në mbledhje e tretë të BE, e pastaj e hapi mbledhjen pasi u konfirmua kuorumi, Kryetari propozoi rendin e ditës, i cili u miratua njëzëri nga Bordi Ekzekutiv:

RENDI I DITËS

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Aktivitetet ndërmjet dy mbledhjeve
3. Rishikimi i Buxhetit – Raporti financiar pas deklarimi të TM1 2026 në MKRS
4. Digjitalizimi
5. Shqyrtimi i raporteve nga **BTTU (U15 & U19) Elbasan, SHQIPERI 2026**
6. Shqyrtimi i raporteve nga - **EYC Gondomar PORTUGALI 2026**
7. MTTU “**International Transalpine Trophy – XXXIV Edition & Mediterranean Cup 2026 – V Edition**”, Bardonecchia (Turin), Itali, 7–9 gusht 2026.
8. ITTF-PTT Coach Course Level I & Youth training camp
9. Mini Champs në Strasburg
10. Afati Kalimtar gusht 2026
11. Emertimi i Nenkryetarit të FPPK-se
12. Emertimi i Delegeve të FPPK-se në KOK
13. Shqyrtimi i rastit të Taibe Rulit - ndarja e bursave nga FPPK
14. Furnizimi i FPPK-se me paisje të pingpongut.
15. Komisioni i Gjyqtarëve.
16. Te ndryshme
 - a. Kërkesa nga Kpp Lidhja e Prizrenit
 - b. Ndryshimet në aktet normative



Pika 1

Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryetari informoi të pranishmit se procesverbali i mbledhjes së kaluar është dërguar me kohë për aprovim e pastaj u është shpërndarë klubeve, por si procedurë është vendos si pikë e rendit të ditës për aprovim formal, Pas diskutimeve të zhvilluara nga të pranishmit, unanimisht u mor ky:

VENDIM

- I. Aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar

Pika 2.

Vendimet përmes viberit dhe Aktivitetet ndërmjet dy mbledhjeve

Kryetari informoi të pranishmit se ndërmjet dy mbledhjeve janë zhvilluar një sërë aktiviteteve për të cilat anëtarët janë njoftuar rregullisht përmes grupit të Viberit, duke përfshirë organizimin e turneut “Dr. Fatmi Fazlija”, turneun “Dita e Çlirimit”, pjesëmarrjen në BTTU në Shqipëri dhe në ETTU në Portugali, si dhe takimet e ndryshme me MSR dhe ITTF – njëra për organizimin e WTT 2026 në Prishtinë dhe tjetra për projektin e fituar nga ITTF për seminarin e trajnerëve dhe kampin për të rinj që pritet të mbahet në gusht; gjatë kësaj periudhe.

Gjatë kësaj periudhe në grupin e viberit janë marrë këto vendime:

1. 15 qershor 2026, vendimi për angazhimin e Ridvan Hashanit si trajner i U19 femra në BTTU në Shqipëri
2. 16 qershor 2026, vendimi për dërgimin e Erina Vranovcit në MTTU në Itali
3. 18 qershor 2026, vendimi për dërgimin e Arijon Krasniqit në MTTU në Itali
4. 22 qershor 2026, vendimi për dërgimin e Sara Hoxhës në BTTU në Shqipëri
5. 24 qershor 2026, vendimi për përgjigjen Kpp Prishtina F lidhur me ankesën për dërgimin e Sara Hoxhës në BTTU në Shqipëri
6. 1 korrik 2026, vendimi për aprovimin e listës për pjesëmarrje në BTTU për Senior në Sarajevë në përbërje: Kreshnik Mahmuti, Fatih Karabaxhaku, Blendi Hajdari, Shega Hashani, Leoresa Imeri, Alma Mehmeti, trajner Rifat Rifati dhe Ridvan Hashani, udhëheqës i rrugës Nehat Çitaku
7. 8 korrik 2026, vendimi për zëvendësimin e Denat Makollit me Atik Heten në MTTU në Itali
8. 8 korrik 2026, vendimi për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për ETTU në Portugali në vlerë 500 euro, në të cilën përfshihen: ushqimi, pijet, transporti lokal sipas nevojës, si dhe shpenzime tjera të domosdoshme.
9. 10 korrik 2026, vendimi për dërgimin e trajnerit të dytë në MTTU në Itali
10. 23 korrik 2026, vendimi për zëvendësimin e Atik Hetës me Marin Hasanin në MTTU në Itali

Pika 3

Rishikimi i Buxhetit – Raporti financiar pas deklarimi të TM1 2026 në MSR

Kryetari informoi të pranishmit se raporti TM1 2026 si dhe raporti WTT 2026 janë mbyllur dhe se tani jemi në pritje të marrjes së TM2 2026. Duke pasur parasysh ndryshimet në buxhetin e aprovuar në fillim të vitit, mos pranimi i T4-shit nga viti 2025 në vlerë prej 54750 euro, është bërë rishikimi i buxhetit për të pasqyruar më realisht gjendjen e mbetur deri në fund të vitit; për këtë



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

qëllim, së bashku me sekretarin është përgatitur një draft i rishikimit të buxhetit i cili u është shpërndarë me kohë anëtarëve të bordit, ndërsa në mbledhje u shqyrtuan të gjitha kontot një nga një. Kryetari bëri një përmbledhje të ndryshimeve dhe më pas sekretari shpjegoi detajet për secilën konto dhe vijë buxhetore, duke prezantuar edhe pasqyrat financiare pas deklarimit të TM1 2026 në MSR.

Pas diskutimeve, Bordi unanimitisht mori këtë:

VENDIM

- I. Miratohet buxheti i rishikuar.
- II. Miratohen pasqyrat financiare.
- III. Raporti i udhëheqësit të rrugës së bashku me shpenzimet të dorëzohet brenda 5 ditë pune pas aktivitetit
- IV. Rritja e shpërblimeve për klube dhe sportist të mbulohet nga sponsoret e ardhshëm potencial.

Pika 4

Digjitalizimi

Kryetari informoi të pranishmit se ka ardhur koha që federata të digjitalizohet në mënyrë që të ecë me trendet modernë dhe të lehtësohet procesi i punës; ai njoftoi se është pranuar një ofertë nga Abedin Bahtiri për një platformë të zhvilluar me inteligjencë artificiale që pasqyron garat dhe ranglistat, si dhe u përmend puna e ish-pingpongistit Blendon Luta, i cili ka mbrojtur temën e diplomës për menaxhimin e të dhënave të federatës. Pas diskutimit të gjerë, ku u përfshinë të gjithë anëtarët e bordit dhe u vlerësua pozitivisht hapi drejt digjitalizimit, u vendos që të hapet një tender publik i hapur për individë dhe kompani të interesuara, me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë për federatën; pas diskutimeve, bordi unanimitisht mori këtë:

VENDIM

1. të bëhet shpallja formale në web e tenderit, duke përfshirë informatat e nevojshme për digjitalizimin e FPPK-së.

Pika 5.

Shqyrtimi i raporteve nga BTTU (U15 & U19) Elbasan, SHQIPERI 2026

Kryetari ia dha fjalën Besimit, i cili ka qenë udhëheqës rrugë në këtë projekt, i cili i njoftoi të pranishmit lidhur me aktivitetin, siç ishte pasqyruar edhe në raportin e dorëzuar nga ai dhe drejtori i përfaqësueses; u theksua se rezultatet e sportistëve ishin në nivelin e pritur, federata jonë u dallua me veshmbathjen unike që u vlerësua pozitivisht krahasuar me federatat e tjera, ndërsa gjyqtarët kosovarë të angazhuar sipas kërkesës së Federatës së Shqipërisë mbajtën barrën kryesore të aktivitetit

U propozua hartimi i një rregulloreje për veshmbathjet e përfaqësueses dhe përcaktimi i procedurës pas përfundimit të projekteve, ndërsa deri në finalizimin e saj të përzgjedhurit duhet të mbajnë veshmbathjen zyrtare të federatës dhe ta kthejnë në rast se u kërkohet.

Pas diskutimeve të zhvilluara nga të pranishmit, unanimitisht u mor ky:

VENDIM



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

- I. Miratohen raportet e dorëzuara.
- II. Të përgatitet një rregullore për veshmbathjet e përfaqësueses deri ne mbledhjen e rradhes
- III. Të përzgjedhurit në aktivitete duhet të mbajnë të veshur veshmbathjen zyrtare nga federata, e ti kthejnë në rast se i kërkohen.

Pika 6.

Shqyrtimi i raporteve nga - EYC Gondomar PORTUGALI 2026

Kryetari informoi të pranishmit për aktivitetin e përfaqësueses në Kampionatin Evropian të të Rinjve të mbajtur në Portugali, ku rezultatet e sportistëve ishin brenda pritshmërive, duke u theksuar se në të ardhmen do të ishte më e përshtatshme të orientohemi drejt aktiviteteve të serisë WTT, të cilat do të rezultonin më të favorshme nga aspekti financiar; gjithashtu u njoftua se është pranuar raporti i aktivitetit nga drejtori i përfaqësueses dhe udhëheqësi i rrugës.

Pas diskutimeve, Bordi unanimisht mori këtë:

VENDIM

- I. Miratohen raportet e dorëzuara

Pika 7.

MTTU “International Transalpine Trophy – XXXIV Edition & Mediterranean Cup 2026 – V Edition”, Bardonecchia (Turin), Itali, 7–9 gusht 2026

Kryetari informoi të pranishmit se, siç është bërë e ditur më herët, për këtë aktivitet të kategorisë U12 do të marrim pjesë vetëm në garat që zhvillohen nga 7 deri më 9 gusht edhe pse ishte parapare që te njejtat të marrin pjesë edhe në kampin që i paraprin këtij turneu.; deri tani janë siguruar biletat e avionit dhe është bërë paraqitja e ekipit, i cili përbëhet nga sportistët Zana Bllaca, Erina Vranovci, Arjan Krasniqi dhe Metin Hasani, si dhe trajnerët Naser Hasani dhe Ylli Maloku.

Pika 8.

ITTF-PTT Coach Course Level I & Youth training camp.

Kryetari informoi të pranishmit për projektin e fituar nga ITTF, në kuadër të të cilit do të organizohet një seminar për trajnerë dhe një kamp për të rinj. Ai njoftoi gjithashtu për takimet e mbajtura së bashku me sekretarin me përfaqësues të ITTF si dhe për takimin që pritet të mbahet së shpejti me ekspertin me të cilin kemi shkëmbyer disa emaille.

U propozua që seminari të mbahet në Prishtinë, në Hotel Marriot, ndërsa kampi për të rinj të zhvillohet në Ferizaj. Për kampin, Drejtori i përfaqësueses do të dërgojë listën e konfirmuar të sportistëve dhe trajnerëve.

Pas diskutimeve, Bordi unanimisht mori këtë:

VENDIM

- I. Seminari i trajnerëve do të mbahet në Prishtinë nese pranohet nje oferte te arsyeshme nga Hotel Marriot, ndërsa kampi në Ferizaj



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

- II. Lista e konfirmuar e sportistëve dhe trajnerëve që do të marrin pjesë në kamp do të aprovohet përmes grupit të Viberit sapo të dërgohet nga Drejtori i përfaqësueses.
- III. Federata do të mbulojë ushqimin dhe transportin për trajnerët (deri 4 persona me një veturë nga i njëjti vend).
- IV. Federata do të mbulojë akomodimin për sportistët dhe trajnerët që nuk janë nga Ferizaj, si dhe ushqimin për të gjithë pjesëmarrësit.
- V. Udhëheqës i këtij projekti do të jetë Nehat Çitaku.

Pika 9.

Mini Champs në Strasburg.

Kryetari rikujtoi të pranishmit se, si shpërblim për rezultatet e arritura në WTT Prishtina, federata ka mbuluar shpenzimet për pjesëmarrjen e sportistëve Zana Bllaca dhe Erina Vranovci së bashku me trajnerët e tyre Naser Hasani dhe Yll Maloku në aktivitetin “Mini Champs” që do të mbahet në Strasburg, Francë.

Ai informoi se është kryer paraqitja dhe janë siguruar biletat e aeroplanit, ndërsa nga ky aktivitet pritet që dy sportistët të përfitojnë përvojë të madhe dhe të vlefshme për zhvillimin e tyre sportiv.

Pika 10.

Afati Kalimtar gusht 2026

Kryetari informoi të pranishmit se Sekretari, në koordinim me Komisionin e Regjistrimit dhe Garave, ka përgatitur njoftimin dhe materialet që do t’u dërgohen klubeve për afatin kalimtar. Sekretari ua prezantoi njoftimin dhe rikujtoi se në këtë afat bëhet edhe ndërrimi i statusit të anëtarëve.

Pas diskutimeve, Bordi unanimisht mori këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet dërgimi i njoftimit dhe dokumenteve shtesë për afatin kalimtar.
- II. Njoftimi të dërgohet para datës 1 gusht

Pika 11.

Emertimi i Nenkryetarit të FPPK-se.

Kryetari informoi të pranishmit se, bazuar në Statutin e FPPK-së, nënkryetari propozohet nga kryetari dhe zgjidhet nga anëtarët e bordit, edhe pse ai theksoi se mendon që nënkryetari duhet të zgjidhet nga Kuvendi. Për të siguruar vazhdimësinë e unitetit të federatës dhe punën e mirë që po zhvillohet, kryetari propozoi që Besim Hajdari të jetë nënkryetar i federatës për mandatin e mbetur.

Anëtarët e pranishëm u pajtuan me propozimin, duke theksuar se Besimi ka qenë edhe më i votuari në Kuvend si anëtar i bordit. Pas diskutimeve, Bordi me vendim unanimit (me një abstenim nga i propozuari) mori këtë:

VENDIM

- I. Besim Hajdari zgjidhet nënkryetar i FPPK-së.



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

Pas vendimit, Besimi falënderoi të pranishmit për besimin e dhënë dhe premtoi se do të vazhdojë të angazhohet me punë të mira për federatën.

Pika 12.

Emertimi i Delegateve te FPPK-se ne KOK

Kryetari informoi të pranishmit për obligimin që federata ka për të dërguar emrat e delegatëve në kuvendet eventuale të KOK-ut. Ai sqaroi se sipas detyrës zyrtare, Kryetari merr pjesë automatikisht, ndërsa duhet të zgjidhen edhe një përfaqësues i gjinisë femërore dhe një i gjinisë mashkullore. Për këtë arsye, ai propozoi Nita Baymak dhe Sheramet Hotin si delegatë.

Pas diskutimeve, Bordi unanimisht mori këtë:

VENDIM

- I. Delegatët e FPPK-së në Asamblenë e KOK-ut janë: Nehat Çitaku, Nita Baymak dhe Sheramet Hoti.

Pika 13.

Shqyrtimi i rastit te Taibe Rulit - ndarja e bursave nga FPPK

Kryetari ia dha fjalën Besimit, i cili informoi të pranishmit për aplikimin e bërë në fillim të vitit për bursa olimpike në KOK, ku fillimisht ishin propozuar katër bursistë dhe më pas u shtua edhe i pesti. Taibe Ruli ishte dërguar si e pesta, edhe pse në nominimin e parë kishte qenë e katërta. Bordi i atëhershëm kishte informuar se për Taiben do të ndahej bursë nga buxheti i FPPK-së.

Sekretari sqaroi procesin, duke rikujtuar se në kohën e aplikimit me pesë emra potencial ishte supozuar se do të përzgjidheshin vetëm dy, siç kishte ndodhur edhe në vitet e kaluara, ndërsa për tre të tjerët ishte diskutuar që të mbuloheshin nga buxheti i FPPK-së. Meqë KOK-u kësaj radhe ka përzgjedhur katër bursistë, në buxhetin e vitit 2026 është paraparë edhe një bursë për një sportist.

Pas diskutimeve u konkludua se është e nevojshme të formohet një komision ad hoc për ndarjen e dy bursave nga federata, ku do të merren parasysh rezultatet e vitit të kaluar, mosha dhe gjinia, e më pas të përzgjidhen dy më të mirët që do të marrin bursë nga federata pa i përfshi katër që janë përzgjedhur nga KOK-u për bursë. Bordi me shumicë të votave (një abstenim) mori këtë:

VENDIM

- I. Formohet komisioni ad hoc për përzgjedhjen e 2 bursistëve në përbërje: Sheramet Hoti, Jahja Tërmkolli dhe Besim Hajdari

Pika 14.

Furnizimi i FPPK-se me paisje te pingpongut.

Kryetari informoi të pranishmit se është shqyrtuar mundësia e blerjes së 30 tavolinave dhe 300 paravanave, si dhe, nëse mbetet buxhet, edhe topa ushtrimesh për klubet. Në buxhetin e rishikuar, nga mjetet e FPPK-së dhe sponsorëve, janë ndarë 32 mijë euro për këto pajisje.

Komisioni i aseteve do të konstatojë gjendjen e klubeve në mënyrë që, kur të arrijnë pajisjet, shpërndarja të bëhet sa më e rregullt. Po ashtu, u propozua hapja e një tenderi për të marrë ofertat përkatëse.

Pas diskutimeve, Bordi unanimisht mori këtë:



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

VENDIM

- I. Të hapet tenderi për blerjen e tavolinave të pingpongut dhe paravanave.
- II. Tavolinat të jenë ITTF approved, modele 25mm ose 28mm, me rrota.
- III. Sekretari të përgatisë dokumentin dhe ta dërgojë fillimisht në BE për aprovim.
- IV. Komisioni ad hoc që do të vlerësojë ofertat të përbëhet nga: Riana Rifati, Gani Pireva dhe Bjondina Hasani.

Pika 15.

Komisioni i Gjyqtarëve

Kryetari informoi të pranishmit se ende nuk është pranuar raporti i punës së Komisionit të Gjyqtarëve, andaj u ngrit çështja nëse duhet të jepet një afat shtesë apo të bëhet ndryshimi i këtij komisioni.

Pas diskutimeve, Bordi unanimisht mori këtë:

VENDIM

- I. Komisioni i Gjyqtarëve deri më 1 shtator ka afatin e fundit për dorëzimin e raportit të punës për vitin 2026
- II. Komisioni i Gjyqtarëve të informohet me email zyrtar nga Sekretari..

Pika 16.

Te ndryshme

a. Kërkesa nga Kpp Lidhja e Prizrenit

Kryetari informoi të pranishmit se është pranuar një kërkesë nga KPP Lidhja e Prizrenit për të mbështetur sportistin Kreshnik Mahmuti lidhur me lëndimin e tij. U diskutua se MSR ka një fond të veçantë për lëndimet, prandaj mbështetja nga federata nuk mbulohet nga fond i pranuar nga MSR-ja dhe, nëse realizohet, duhet të bëhet nga mjetet vetanake të FPPK-së ose nga ndonjë sponsor eventual. Sheramet Hoti propozoi që Kreshniku të mbështetet me shumën prej 500 euro.

Pas diskutimeve, Bordi unanimisht mori këtë:

VENDIM

- I. Të mbështetet Kreshnik Mahmuti me 500 euro nga fondi i federatës.
- ##### b. Ndryshimet në aktet normative

Kryetari informoi të pranishmit për rëndësinë e përmirësimit të akteve normative të federatës dhe theksoi se gjatë periudhës së pushimeve është e nevojshme të formohet një komision ad hoc për të rishikuar të gjitha rregulloret si dhe Statutin e FPPK-së.

Pas diskutimeve, Bordi unanimisht mori këtë:

VENDIM

- I. Komisioni ad hoc për rishikimin e akteve normative të federatës të përbëhet nga: Sheramet Hoti, Nehat Çitaku dhe Nita Baymak.

Mbledhja përfundoj në ora 22:45

Procesmbajtës

Fadil Luta

Kryesuesi i mbledhjes

Nehat Çitaku